


 Menu

HOME > NEWS

Njoftim për shtyp, datë 25 Mars 2022

25 March, 2022 by **KLJGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot në datë 25.03.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës ku shqyrtoi çështjet si vijon:

Këshilli miratoi vlerësimin dhe pikëzimin paraprak të kandidatëve, si dhe listën e kandidatëve më të mirë që konkurojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.1' 

datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të përbërë nga z. **Darjel** Sina. Pasi zhvilloi edhe intervistën me kandidatin për këtë pozicion të Gjykatës së Lartë, Këshilli vendosi miratimin e vlerësimit dhe pikëzimit përfundimtar.

Në vijim, Këshilli vendosi mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor{...}, znj.{...} për shkak të dorëheqjes së saj.

Gjatë mbledhjes plenare u vendos mbi verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. Vojsava Kola (Osmanaj) të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.536 dhe nr.537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këto dy pozicione, dhe përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit.

KLJGJ përgjatë mbledhjes vendosi gjithashtu, përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, për kandidaten znj. {...}.

Ndër të tjera, Këshilli vendosi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për dy pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290 datë 06.07.2021, për kandidatin z.{...}.

Këshilli gjithashtu vendosi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin nr. 181 dhe vendimin nr.183 datë 28.05.2020, për kandidatin z.{...} dhe znj.{...} si dhe përfundimine procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale për znj.{...}.

Në përfundim KLJGJ vendosi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.



[Previous](#)

[Next](#)

Njoftim për shtyp, datë 29 Mars 2022

Pjesëmarrja e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor në tryezën ndërkombëtare me temë “Formësimi i Këshillave Gjyqësor për të përballuar sfidat bashkëkohore”

Publikime



Njoftime për shtyp





Vende Vakante



Kalendari i eventeve

« MAY 2022 »						
M	T	W	T	F	S	S
25	26	27	28	29	30	1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29

« MAY 2022 »						
M	T	W	T	F	S	S
30	31	1	2	3	4	5

@2020 Keshilli i Lartë Gjyqësor

